

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT			
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I TRANSPORTA			
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION			
Njësia org.	Nr. Prot.	8748	
Org. Jedinica	Broj Prot.		
Org. Unit	Prot. No.		
Nr. I Faqeve	Data:	24.08.26	
Br. Stranica	Datum:		
No. Pages	Date:		
PRISHTINË/A			



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo Infrastrukture i Transporti
Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, , në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), bazuar ne dispozitat e nenit 7 (paragrafi 2) të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndër urban të udhëtarëve me autobus dhe nenit 19 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë

VENDIM

I. Refuzohet, kërkesa nr.242 date 18.02.2026 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus NPT“PLISI COMMERC” Qazim Mustafa BI me seli në Ferizaj për marrjen e nisjeve ne relacionin: Ferizaj-Brezovicë me oraret e nisjeve Ferizaj - Brezovicë (08:00-12:30; 14:00-19:00).

Arsyetim

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, Rrjetin aktual të nisjeve nderurbane **konstaton** se nisjet e lartcekura pengojnë ne nisjet ekzistuese të vërtetuara nga MMPHI-ja ne këtë relacion pasi qe operatorët tjerë posedojnë rendet e udhëtimit valide të

vërtetuar në orarin e njëjtë (prova: R.U nr.55/05/23, 56/05/23) në kthim duke rrezikuar kohën mbrojtëse të operimit ndërmjet nisëve respektive në relacionin në fjale.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.

Dimal Basha

Ministër



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.